



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të FSHU-së

Përgjigjet ndaj Komenteve (FSHU-së)

Viti relevant tarifor 2018

DEKLARATË

Ky Raport është përgatitur nga ZRRE-ja me qëllim të informimit të palëve të interesuara të sektorit të energjisë. Ky raport nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

15 Shtator 2018

Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Përshtatjet për vitin 2016 dhe 2017	4
2.1	<i>Komentet e KESCO-së.....</i>	4
2.2	<i>Përgjigjet e ZRRE-së</i>	4
2.3	<i>Komentet e KESCO-së dhe FSPE-së për shpenzimet e personelit</i>	6
2.4	<i>Përgjigjet e ZRRE-së</i>	6
3	Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin 2018.....	6
3.1	<i>Komentet e KESCO-së.....</i>	6
3.2	<i>Përgjigjet e ZRRE-së</i>	7
4	Propozimi përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin 2018	8



1 Hyrje

Pas vlerësimit fillestar të Aplikacionit lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU - KESCO), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë të MAR për FSHU, përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KESCO kanë pasur disa takime për të sqaruar kalkulimet në vlerësimin fillestar. Nga ky proces interaktiv i komunikimit ndërmjet ka rezultuar në disa plotësime, e të cilat janë reflektuar në propozimin përfundimtar të ZRRE-së.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe propozimin e ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, ZRRE ka pranuar komente nga KESCO, Sindikata e Punëtorëve të KEDS/KESCO. Komentet e të gjitha palëve janë të shtjelluara më poshtë.



2 Përshtatjet për vitin 2016 dhe 2017

2.1 Komentet e KESCO-së

Bazuar në të dhënat e pranuar nga ZRrE-ja, si dhe analizat e brendshme, FSHU përgjithësisht pajtohet me qëndrimin e ZRrE-së, mirëpo ka disa komente të veçanta për të cilat kërkon rishikimin nga ZRRE.

KESCO ka komentuar ndryshimin e qasjes së përshtatjes së kostove të shitjes me shumicë për vitin 2016. Duke marrë parasysh ndryshimet në Rregullën për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal KESCO beson që qasja është e saktë, mirëpo për shkak të përshtatjeve të vitit 2016, i cili i takon periudhës së kaluar, atëherë ZRRE duhet të jetë konsistente në qasjen e saj dhe të bëjë përshtatjet sipas rregullave të vitit 2011.

KESCO gjithashtu pajtohet me qasjen e ZRRE-së në lidhje me blerjet e energjisë me shumicë nga importi dhe trajtimin e energjisë për eksport të KEK-ut. Megjithatë, KESCO pretendon se ZRrE nuk ka aplikuar një korrigjim në vlerat e importit siç është informuar nga KESCO më 20 shkurt 2018, pas kërkesës së ZRrE-së për sqarim, prandaj ky korrigjim duhet të aplikohet saktë gjatë llogaritjes së kostove aktuale të shitjes me shumicë për vitin 2017.

FSHU ka komentuar edhe qasjen e ZRRE-së lidhur me aplikimin e vlerave tjera për detyrimet e FSHU-së ndaj KOSTT-it nga ato të përdorura në aplikimin e FSHU-së për MAR.

MAR-i aktual i vitit 2017 i përdorur nga ZRrE-ja nuk i ka konsideruar pagesat për taksën e licencës të cilat përbëjnë 182 mijë euro, si dhe nuk e ka konsideruar korrigjimin për rimbursim për alokimin jo të saktë të tarifave të KOSTT-it në vitin 2016, për të cilën FSHU është dëmtuar dhe si rezultat duhet të kompensohet.

FSHU ka vërejtur se ZRrE ka llogaritur faturimin aktual për vitin 2017, duke zbritur 1.8% të TVSH-së për të gjitha kategoritë në formë lineare, por duhet të konsiderohet se jo të gjithë konsumatorët paguajnë TVSH, prandaj ZRrE-ja duhet të konsiderojë faturimin neto të paraqitura nga FSHU para aplikimit të normës së TVSH-së.

FSHU pretendon që ZRRE nuk duhet të përfshijë të gjithë rikthimin e humbjeve në vlerën e energjisë së faturuar, duke u nisur nga pamundësia e FSHU-së që të arkëtoj të gjithë vlerën për energjinë nga rikthimi i humbjeve si pasojë e proceseve gjyqësore, ku sipas praktikave vetëm 20% e energjisë së faturuar arrin të arkëtohet brenda vitit relevant.

2.2 Përgjigjet e ZRRE-së

Marzha me pakicë – sa i përket pretendimit të FSHU në lidhje me ndryshimin e qasjes së kalkulimit të përshtatjes së kostos së energjisë me shumicë, përkatësisht përfshirjen e kostos së marzhës me pakicë në përshtatje, ZRRE dëshiron të konfirmoj se qasja e përdorur në përshtatjet e vitit 2016 është e njëjtë me atë të përdorur gjatë periudhës së parë rregullative dhe se nuk ka ndryshime të pretenduara nga FSHU. Ndërsa sa i përket përshtatjeve të vitit 2017, ZRRE përshtatjet e të gjitha kostove i ka bërë në pajtim me rregullat e reja, sipas të cilave duhet bërë vlerësimi i kostove aktuale



për furnizimin me energji elektrike dhe të hyrave aktuale nga faturimi. Në këtë kuptim marzha e kostos me pakicë është komponenti i përfshirë në kostot e blerjes së energjisë me shumicë.

Kosto e importit - Në aplikacionin fillestar të dorëzuar nga FSHU në lidhje me MAR, vlera e importit është prezantuar si total i importeve për të tre të licencuarit (FSHU, KOSTT dhe KEDS) në vlerë prej 48.4mil€. Mirëpo ndarja e importit sipas të licencuarve, ku përfshihet importi për humbjet në Transmetim dhe Shpërndarje, ka krijuar disa versione duke pësuar kohë pas kohe korrigjime që kanë sjellë rialokim të kostove të importit ndërmjet të licencuarve, përkundër që totali në kosto të sistemit ka mbetur i njëjtë. Në këtë kuptim edhe dokumentet e datës 20 shkurt të cilat KESCO ka kërkuar të merren në konsideratë nga ZRRE nuk paraqesin vlerën reale të importit të FSHU, sidoqoftë ZRRE ka analizuar kostot e importit për FSHU dhe ka paraqitur ato në vlerësimin përfundimtar të MAR për FSHU.

Faturimet ndërmjet KESCO dhe KOSTT - ZRRE ka pranuar të dhëna të ndryshme nga KESCO dhe KOSTT dhe gjatë kalkulimit të MAR për FSHU, dhe vlerësimin fillestar të saj e ka bërë sipas bindjes së ZRRE. Pas komenteve të pranuar nga FSHU, ZRRE ka rishikuar dhe vërtetuar faturimet në baza mujore ndërmjet palëve dhe ka paraqitur ndryshimet në propozimin përfundimtar për MAR të FSHU. Lidhur me rimbursimin e FSHU për vitin 2016 që ka të bëjë për alokimin jo të saktë të tarifave të KOSTT-it në vitin 2016, ZRRE përmes faktorit korrigjues të të hyrave (KREV) ndaj KOSTT ka kompensuar FSHU në vlerë rreth 1mil€, dhe kompensimi i kërkuar nga KESCO do të paraqiste kompensim të dyfishtë, lidhur me këtë ZRRE ka ofruar KESCO-së të dhënat në formatin *Excel* ku përfshihet korrigjimet e vitit 2016.

Kosto e licencës - ZRRE ka marrë parasysht komentin e FSHU për mospërfshirje në propozimin fillestar dhe ka bërë përshtatjen e kostove të licencës për vitin 2017, përveç kësaj ZRRE ka kompensuar edhe kostot e licencës për vitin 2016 në vlerë rreth 8 mijë euro.

Faturimi - Lidhur me faturimin e energjisë të realizuar të paraqitur nga ZRRE dhe atë të paraqitur nga FSHU ka një dallim prej rreth 3 mil€, ndërsa sa i përket mos përfshirjes apo lirimit nga TVSH në faturim të disa konsumatorëve, ZRRE e ka zbritur nga faturimi vlerën e TVSH në kalkulimin të faturimit. Ashtu siç ka komentuar FSHU, disa konsumatorë janë të liruar nga TVSH, e cila do të ndikojë vetëm në rritje të neto faturimit.

Rikthimi i humbjeve – Të hyrat dhe shpenzimet bazohen në parimin e aktualitetit, që nënkupton se ato regjistrohen në momentin që ndodhin dhe jo nëse ato janë arkëtuar. Prandaj ZRRE trajton rikthimin e humbjeve si të hyra në momentin që regjistrohen si të tilla, ndërsa i nënshtrohen borxhit të keq në rast se ato nuk mund të arkëtohen sipas ligjeve në fuqi. ZRRE inkurajon FSHU që të bëjë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e inkasimit dhe të përmirësoj aspektin teknik të trajtimit të rikthimit të humbjeve.

Përshtatjet për CAPEX 2013-2017 - ZRRE për periudhën rregullative 2013-2017 ka lejuar investime kapitale për aktivitetin e furnizimit në vlerë prej 1.97 mil€. Pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të prezantuar nga FSHU dhe pasqyrave financiare, konstatohet si niveli i realizuar i CAPEX-it për këtë periudhë është në vlerë prej 0.5mil€. Këto korrigjime përfshijnë edhe korrigjimin e zhvlerësimit të lejuar për vitin 2014 duke ju referuar komenteve të KESCO në atë kohë. Ashtu si në përshtatjet tjera, kalkulimet janë bërë duke marrë parasysht vlerën kohore të parasë. Vlera e



përshtatjeve të (PRR1) për CAPEX është 0.13 mil€. Korrigjimi për këto përshtatje do të aplikohet gjatë vitit relevant tarifor 2018.

Në kuadër të shqyrtimit të CAPEX-it për PRR1, ZRRE ka rishikuar edhe vlerën e Bazës së Rregulluar të Aseteve të FSHU-së, dhe ka kalkuluar vlerën hapëse të vitit 2018 dhe zhvlerësimin e lejuar për këtë vit. Vlera e kostove të zhvlerësimit për vitin 2018 është 0.106 mil€.

2.3 Komentet e KESCO-së dhe FSPE-së për shpenzimet e personelit

Shpenzimet operative është kërkuar nga sindikata që të marrin parasysh edhe nivelizimin e pagave, respektivisht është kërkuar që të kemi parasysh se në KEDS/KESCO që nga viti 2013 ende ka me qindra vende pune të cilat nuk i kanë të nivelizuara pagesat sipas pozitës, po ashtu në komentet e sindikatës theksohet edhe dallimi ndërmjet nivelit të pagave të KEDS-it dhe të licencuarve tjerë në sektorin e energjisë.

2.4 Përgjigjet e ZRRE-së

Edhe pse komentet e KESCO-së dhe FSPE janë të dhëna vetëm në Raportin Konsultativ të KEDS-it, duke qenë se në ato komente adresohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me kostot e personelit për KEDS dhe KESCO, ZRRE do të trajtojë ato edhe si komente ndaj Raportit Konsultativ për FSHU dhe do të japë përgjigjet për to.

ZRRE-ja ka marr parasysh kërkesën e FSPE dhe ka lejuar kosto shtesë për personelin e KESCO-së në vlerë prej 251 mijë euro që ka të bëjë me rritjen e kostove të personelit duke përfshirë edhe kostot për përvojën e punës. Duke qenë se 2.05 mil€ tani më ZRRE i ka përfshirë në të hyrat e lejuara të KEDS-it, dhe 0.25 mil€ në të hyrat e KESCO, shuma totale prej 2.3 mil€ e kostove shtesë të personelit të të licencuarve KEDS dhe KESCO është e pranueshme krahasuar me kostot e personelit të të licencuarve tjerë në sektorin e energjisë.

3 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin 2018

3.1 Komentet e KESCO-së

FSHU në përgjithësi pajtohet me qasjen e përdorur nga ZRRE lidhur me propozimin për kostot e parashikuara për vitin 2018, megjithatë pretendon se disa aspekte, siç është niveli i borxhit të keq, duhet të rishikohet nga ZRRE dhe të jetë 6%, duke marrë në konsideratë për shkak të ndryshimeve në treg, respektivisht zvogëlimit të numrit të konsumatorëve industrial dhe komercialë - të cilët janë pagues të rregullt. Nga viti 2018, FSHU ka mbetur kryesisht me konsumatorë të cilët kanë tendencë të vonojnë dhe/ose refuzojnë pagesat e faturave të pranuar, prandaj dhe meqenëse në bazë të ligjit të ri nuk lejohet shkyçja e konsumatorëve që ankohen tek institucionet relevante derisa të ketë një vendim nga gjykata, dhe marr parasysh veprimet e ngadalta të gjykatave në Kosovë, operimet do të bëhen të pamundura për t'u trajtuar.



3.2 Përgjigjet e ZRRE-së

Rregullatori në përcaktimin e të Hyrave për KESCO lejon një nivel të arsyeshëm të borxhit të keq, duke u bazuar në të dhënat historike dhe pritshmërinë për përmirësim të performancës. Gjithashtu një faktor i rëndësishëm gjatë përcaktimit të nivelit të borxhit të keq, është edhe krahasimi me operatorët tjerë në vendet e rajonit dhe vende tjera me karakteristika të ngjashme rregullative dhe ekonomike. Prandaj, ZRRE inkurajon operatorin që të bëjë përpjekje për të ruajtur nivelin e borxhit të keq nën nivelin e lejuar.

Përkundër shqetësimeve të KESCO për derregullimin e çmimeve dhe ndikimit të tij në rritjen e borxhit të keq, ZRRE konsideron që pretendimet e KESCO nuk janë të arsyeshme në këtë kohë. Në shqyrtimet e ardhshme të parametrave, ZRRE ndër tjera do të rishqyrtoj edhe rrethanat e reja të krijuara pas derregullimit.

ZRRE konsideron që niveli i lejuar i borxhit të keq prej 4% është i arsyeshëm dhe propozon që ky nivel të vazhdoj edhe për këtë vit relevant tarifor.



4 Propozimi përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU për vitin 2018

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe ato të paraqitura nga palët e përfshira në proces dhe palët e interesit, si dhe pas komenteve të pranuar nga KESCO dhe FSPE gjatë konsultimit publik, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim universal (FSHU) për vitin 2018 është si më poshtë:

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	2018
Parametrat e indeksimit		
Norma e inflacionit		1.4%
Norma e interesit It	%	6.9%
Kostot me pakice te furnizuesit		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.96
Zhvlerësimi - $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.11
PERSHTATJET PER CPI 2017	€m	0.09
Kostot e bartshme		
Kostot e OST	€m	20.29
Kostot e OSSh	€m	83.46
Fondi BRE		2.50
Kapitali Punues (WCLCt)		
$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.28
Kostot per blerjen e energjisë		
Total blerjet e energjisë	€m	110.49
Taksa per licencës		
Taksa per licence	€m	0.06
Përshtatjet		
Përshtatjet 2017	€m	-17.10
Përshtatjet 2016		-1.52
Përshtatjet për CAPEX-PRR ₁		0.13
Borxhi i keq (BDTA)		
BDTA	%	4.0%
BDTA	€m	8.57
FINAL MAR	€m	214.32

Për shkak të hyrjes në fuqi në tarifave të të licencuarve (KOSTT, KEDS dhe FSHU) nga muaji tetor dhe jo nga muaji prill, ZRRE do ta trajtojë ndryshimin në mes të vlerësimit të saj për të Hyrat e Lejuara të nevojshme për FSHU-në dhe të Hyrave që FSHU pritet t'i mbledhë nga tarifave si masë balancuese. Ky ndryshim do të alokohet në Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT). Bilanci i kësaj llogarie do të përshtatet duke mos marr parasysh normën e interesit nga kjo përshtatje që rezulton si vonës e hyrjes në fuqi të tarifave sipas kohës së paraparë është jashtë kontrollit të të licencuarve. Në vitin vijues tarifor, LBT-ja do të jetë në dispozicion dhe, sipas vlerësimit të ZRRE-së, do të përdoret për të zbutur ose eliminuar rritjet e tarifave. Çdo pjesë e papërdorur e LBT-së apo çdo shtesë e LBT-së ,si pasojë e vendimeve të ZRRE-së, do të bartet në vitet e ardhshme tarifore.

Vlera e cila do të kreditohet si llogari balancuese tarifore është 9.5mil€, kjo vlerë që do të ndikonte në zbutjen e rritjes ekscesive të tarifave në të ardhmen.